

## RELACION TEKNIK


**LOT III- Rikualifikimi i Pazarit te Ri (Markata e Mish-Peshkut, restaurimi i 4 objekteve dhe rikonstruksioni i fasadave perreth sheshit Avni Rustemi dhe paisjet)**

*Restaurimi i 4 Objekteve*



*Ndërhyrjet restauruese të objekteve monument kulture dhe vëna në mbrojtje paraprake në sheshin “Avni Rustemi” dhe Pazarin e Ri.*





Sheshi “Avni Rustemi” ndodhet rreth 500 m larg sheshit kryesor të qytetit të Tiranës. Që prej vitit 2007 ky shesh gëzon statusin monument kulture i kategorisë së dytë. (vendim nr. 122, qershor 5th 2007).



*Fig. 1 –Lidhja e sheshit “Avni Rustemi” me qendrën e qytetit të Tiranës*




*Fig. 2 – Majtas – Planimetria e Sheshit “Avni Rustemi” në vitin 1926;  
Djathtas – Planimetira e Sheshit “Avni Rustemi” aktualisht*

Legjendë:  Objekti nr. 1;  Objekti nr. 2;  Objekti nr. 3;  Objekti nr. 4  
Objekti nr. 1:

### 1. Përshkrim arkitektonik.

*Projekti i vitit 1926 i krahasuar atë me gjendjen faktike.*

Objekti është ndërtuar në vitin 1935, 4 vite pas ndërtimit të Pazarit. Projekti origjinal është hartuar në vitin 1926 nga dy arkitektë italianë (T. Giuliani dhe G. Beçari) me porosi të familjes Kërçiku. Sipas këtij projekti objekti kishte katër kate mbi tokë dhe një podrum. Mbulimi i tij ishte parashikuar të realizohej me tarracë të përdorëshme deri në një masë shumë të vogël.



*Fig. 3 – Majtas: Vulat e miratimit të projektit në vitin 1926;  
Djathtas: Prerje e objektit ku evidentohet tarraca e shfrytëzueshme*

Objekti ka sistem konstruktiv të kombinuar: perimetralisht ndërtuar me mure mbajtës 50 cm me tulle masive, ndërsa muret ndarës dhe parapetet e ballkoneve janë me trashësi 15 cm dhe realizuar me tullë të lehtësuar. Përveç mureve perimetralë, objekti ka dhe një aks kolona betoni (seksion 40x40 cm), sipas drejtimit gjatësor të objektit. Mbulimi i katit të fundit është bërë me çati me tjegulla marsejeze, ndryshe nga çfarë është në projektin origjinal ku kati i fundit mbulohet me tarracë dhe është pjesërisht i shfrytëzueshëm, i parashikuar për lavanderi. Nuk ka të dhëna historike të shkruara për këtë objekt që të mund të ketë të dokumentuar përse është bërë ky ndryshim dhe nëse është bërë gjatë zbatimit të projektit apo është ndërruar në vitet e mëvonëshme të përdorimit. Por nga vërtetimet në objekt kuptohet që çatia është ndërtuar që në kohën e ndërtimit të vetë objektit. Pra kemi të bëjmë me një ndryshim projekti gjatë zbatimit të tij. Arsyeet përse është bërë ky ndryshim janë ende të paqarta.

Në projektin original *kati i podrumit* me lartësi 300 cm, ka qenë parashikuar për të qenë birrari. Ky kat merrte dritë dhe ajrim nga disa dritare horizontale të vendosura në nivelin e kuotës zero të terrenit përgjatë gjatësisë së faqes perëndimore, jugore dhe pjesërisht asaj lindore të objektit. Sot këto dritare janë të mbyllura nga shtresat që i janë shtuar terrenit duke e bërë kështu këtë kat tërësisht të paajrosur dhe të pa ndriçuar. Në ndryshim nga projekti, kati i podrumit sot është një hapësirë e vetme, pa mure ndarëse.




Fig. 4 – Majtas – planimetria e podrumit sipas projektit; djathtas: planimetria e podrumit e zbatuar.

*Kati përdhe* duke qenë se në projekt ka qenë parashikuar për aktivitet tregtar ka dhe lartësi më të madhe se çdo kat tjetër. Është i organizuar nënë pesë njësi-dyqane, funksion që objekti e ka edhe sot. Projekti original ka parashikuar që kati përdhe të mos shfrytëzohet plotësisht por gjysma perëndimore e tij të ishte pasazh (portik) që të përdorej nga kalimtarët. Objekti ka qenë i tillë, me pasazh në gjysmën perëndimore të katit përdhe, që nga krijimi i tij deri rreth viteve 2000. Aktualisht pasazhi nuk ekziston, kati përdhe shtrihet dhe shfrytëzohet plotësisht.




Fig. 5 – Majtas – plani i katit përdhe - projekt; djathtas: plani i katit përdhe aktual

Kati tip (kati i parë, i dytë dhe i tretë) ka lartësi 340 cm dhe është parashikuar të ketë funksion banimi; të njëjtin funksion që mban edhe sot. Në çdo kat ka nga dy apartamente: njëri prej të cilëve ka tre dhoma gjumi, një dhomë ndenjjeje, një kuzhinë gatimi, dy banja dhe tre ballkone, ndërkohë që apartamenti i dytë përbëhet nga nga dy dhoma gjumi, një

dhomëndentjeje, një kuzhinë, një banjë dhe dy ballkone. Apartamentet kanë qenë përdorur vazhdimisht për banim duke bërë që ata të mos i nënshtrohen ndryshimeve drastike në zhvillimin e tyre planimetrik. Aktualisht katet tip të të objektit të ruajnë zhvillimin e brendshëm sipas projektit të vitit 1926.




Fig. 6 – Majtas – plani i katit tip - projekt; djathtas: plani i katit të parë – aktual




Fig. 7 – Majtas – plani i katit të dytë - aktual; djathtas - plani i katit të tretë – aktual

Ndryshe nga projekti, katet e banimit ndryshojnë nga njëri tjetri në disa elementë të rifiniturës së jashtme. Kati i parë ka numrin maksimal të ballkoneve; kati i dytë ka një ballkon më pak në faqen jugore të tij, madje në atë pozicion nuk ka as dritare dhe as ballkon. Gjatë zbatimit është zgjedhur që kjo faqe të ishte e tillë. Themi gjatë zbatimit dhe jo të jetë mbyllur më vonë sepse në anën e brendëshme të muraturës nuk ka gjurmë të paturës së derës ose dritares si dhe në anën e jashtme mungon parapeti i dritares ose elementët dekorativë përreth dritares ose derës. Në katin e tretë ballkonet mungojnë tërësisht.

*Plani i mbulimit* të objektit në projekt është parashikuar të realizohet me tarracë, një pjesë e vogël e së cilës është e parashikuar për të qenë lavanderi. Por projekti nuk është zbatuar e rigorozitet. Një nga ndryshimet më të mëdha është pikërisht mbulimi i objektit me *çati vendime* konstrukcion dru pise të mbështetur mbi muret anësore dhe mbi kolonat e betonit, e mbuluar me tjegulla marsejeze. Çatia nuk ka shtresë hidroizoluese; tjegullat vendosen drejtëpërdrejtë mbi mahitë e drurit të cilat qëndrojnë mbi binarët tërthorë.




Fig. 8 – Majtas – plani tarracës -projekt; djathtas – plani i mbulimit të çatisë – aktual





Fig. 9 – Majtas – plani dhe konstrukcioni i çatisë; djathtas –detaj i mbështetjes së çatisë mbi murin mbajtës

Dyert e ballkoneve si dhe dritaret janë të realizuara me dru pishe dhe janë të gjitha të pajisura me grila druri; edhe këto të realizuara me dru pishe. Me përjashtim të dy dritareve dhe dy dyerve të ballkoneve në fasadën perëndimore të objektit, grilat e të cilave janë bërë të reja vitet e fundit, në të gjitha dritaret dhe dyert e ballkoneve të tjerë në katet tip, janë

të vendosura ende grilat e vendosura që në vitin e ndërtimit të objektit, por të dala jashtë funksionit. (materiali i tyre është i degraduar, mungojnë elementë të grilave, u janë prishur meknizmat e hapjes dhe mbylljes, etj.)




Fig. 10 – Majtas – dritaret e katit të parë; djathtas – dritaret e katit të dytë dhe të tretë

*Suvatime dhe lyerje.* I tërë objekti është i suvatuar me një shtresëllaçi prej 1.5 cmtë trashë, të pregatitur me rërë, gëlqere dhe një sasi të vogël çimentoje. Objekti nuk është nënshtruar asnjëherë ndonjë procesi gjeneral risuvatimi; aktualisht objekti ka ende shtresën origjinale të suvasë me të gjithë elementët dekorativë të saj. Ndryshe nga shtresa e suvasë, ngjyra e sipërfaqes së jashtme të mureve të objektit është ndryshuar disa herë që nga periodha e ndërtimit të tij. Në objekt u kryen sondazhe në vende të ndryshme për të identifikuar ngjyrën fillestare të lyerjes së sipërfaqes së mureve. Po me këtë ngjyrë do të bëhet edhe lyerja e objektit në zbatim të projektit të restaurimit.



Fig. 11 – Sondazh për evidentimin e ngjyrës origjinale të lyerjes së fasadës. Majtas sipërfaqja e muraturës dhe dekorit. Djathtas, krahasimi i një kampioni të marrë në objekt dhe përcaktimi i kodit të ngjyrës për lyerjen.

*Sondazhet për të evidentuar ngjyrën origjinale realizohen nëpërmjet goditjeve të lehta me spatul mbi sipërfaqen e muraturës duke bërë të mundur kështu heqjen me kujdes të shtresave*

të ndryshme të bojës deri sa të arrijmë në sipërfaqen e llaçit të suvasë. Ngjyra e shtresës së fundit të bojës përcakton edhe ngjyrën me të cilën do të lyhet objekti pas ndërhyrjeve restauruese.

Sipërfaqja e muraturës së katit përdhe është e veshur deri në lartësinë 180 cm me pllaka graniti me trashësi 2 cm. Kjo veshje i është bërë pas mbylljes së pasazhit të katit përdhe në vitin 2000.

*Elementët dekorativë* të objektit janë të paktë dhe të thjeshtë. Të gjithë elementët dekorativë janë të realizuar me llaçimento, por me përqindje më të lartë të këtij ingredienci në sasinë llaçit duke i dhënë atij fortësi më të madhe se suvaja e objektit. Kjo është edhe arsyeja përse elementët dekorativë ruhen mjaft mirë në të gjithë objektin. Ndër elementët dekorativë bien në sy tre korniza horizontale të cilat e përshkojnë objektin perimetralisht në tre nivele të ndryshme: në nivelin e soletës midis katit përdhe dhe atij të parë; në nivelin e soletës midis katit të dytë dhe atij të tretë; në nivelin mbylljes së katit të tretë. Përveç funksionit estetik, këto korniza shërbejnë edhe për disiplinimin dhe orientimin e ujërave të shiut. Nëpërmjet pjerrësisë që secila nga këto korniza ka në drejtim nga jashtë, si dhe profilit të tyre i cili realizon edhe pikoren, bën që ujërat e shiut të mos depozitohen pranë sipërfaqes së mureve.



*Fig. 12 – Elementët dekorativë të objektit. Majtas – elementët dekorativë horizontale perimetralisht objektit; djathtas – elementët dekorativë rreth dritareve si dhe parapeti i dritareve i trajtuar me një lloj profili me rol edhe estetik edhe funksional (për kullimin e ujërave larg sipërfaqes së objektit)*

Përveç kornizave horizontale objekti dekorohet edhe nëpërmjet kornizave të dritareve dhe dyerve si edhe nga trajtimi dekorativ i parapeteve të tyre. Kë katin e parë, përveç elementit dekorativ që i vendoset perimetralisht përreth dritareve dhe dyerve të ballkoneve



ështërealizuar edhe njëelement tjetër dekori. Suvaja e muraturës këtu është thelluar rreth 1.5 cm duke krijuar kështu siluetën e një kornize tjetër rreth 20 cmtë gjerë përreth dritareve dhe dyerve të ballkonit. Ky element nuk përsëritet në katet e mësipërme. (shiko fig. 10)

Në katin përdhe nuk ka elementë dekorativë, as në projekt nuk kanë qenë të parashikuar dhe as aktualisht nuk ka.

## ***2. Përshkrim i gjendjes së konservimit dhe degradimet;***

Objekti përgjithësisht gëzon një gjendje të mirë konservimi. Nuk shfaq problematikë në sistemin e tij konstruktiv. Degradimet e objektit janë të nivelit sipërfaqësor, suva, elemente dekori, dyer dritare si dhe tjetërsime të bëra në kohë nga përdoruesit.

Përgjithësisht degradimet kanë ardhur prej agentëve atmosferikë dhe mungesës së ndërhyrjeve mirëmbajtëse apo përmirësuese në objekt që nga koha e ndërtimit të tij. Kjo gjë ka bërë që suvaja të degradohet.

Që nga viti 1935,viti kur është ndërtuar, objekti nuk i është nënshtruar ndonjë ndërhyrjeje restauruese gjenerale. Herë pas here janë kryer punime lokale mirëmbajtëse të cilat ishin në formën e meretimeve të kryera nga vetë banorët për të zgjidhur nevojat e çastit. Shpesh, këto ndërhyrje individuale, e kanë tjetërsuar ose e kanë dëmtuar objektin duke i ndryshuar një zhvillim planimetrik të brendshëm, ose duke dëmtuar elementët e dekorit në fasadë.

Dëmtime serioze shfaq *çatia*; të shkaktuara kryesisht nga depërtmi i ujërave të shiut nga tjegullat në elementët e konstruksionit. Hidroizolimi i tij i ështëbesuar vetëm shtresës së tjegullave të vendosura drejtpërdrejtë mbi mahitë e drurit.



*Fig. 13*  
*Konstruksioni i dukshëm i çatisë ku vihen re mungesa e shtresës hidroizoluese si dhe elementëve përbërës të çatisë*

Mungesa e shtresës hidroizoluese si dhe dëmtimi në kohë i tjegullave kanë bërë të mundur futjen lehtësisht të ujërave të shiut brenda nëobjekt duke dëmtuar elementët drusorë

tëkonstruksionit. Çatia mund të shihet vetëm në një zonë të caktuar të objektit (në zonën veriore të tij) ku mungon tërësisht tavani dhe konstruksioni bëhet i dukshëm. Pjesa tjetër është e pa mundur të inspektohet. Nga inspektimi i bërë në objekt, vihet re që konstruksioni i çatisë (trarët kryesorë) janë të dëmtuar deri në masën 50% të tij. Por ky gjykim është vetëm me sy të lirë. Një inspektim më i detajuar i elementëve drusorë të konstruksionit të çatisë mund të bëhet vetëm pas nisjes së punimeve (projekti i restaurimit mbaron me mbylljen e punimeve restauruese, që do të thotë se gjatë procesit të restaurimit ka gjithmonë punime të paparashikuara në projekt, sepse me hapjen e objektit mund të evidentohen degradime ose problematika të pa evidentuara gjatë fazës së dokumentimit dhe rilevimit të gjendjes ekzistuese dhe përcaktimit të gjendjes së konservimit.)

Trarët kryesorë të çatisë mbështeten mbi trarë betoni të cilët në vetvete mbështeten drejtpërdrejtë mbi muraturën mbajtëse. Gjatësia e trarëve kryesorë është sa gjerësia e objektit. Korniza e çatisë është e realizuar me llaç cimento.

Ndër degradimet më masive bie në sy degradimi që ka pësuar *shtresa e suvasë*. Nuk ka literaturë ose dokumentacion të shkruar për ndërhyrjet që mund të jenë bërë në objekt ndër vite por duke vërejtur me imtësi, në zonat e parapeteve të ballkoneve vihen re dy viza paralele të thelluara në suva në drejtimin horizontal. Këta elementë duhet të jenë realizuar që në ndërtimin e objektit në 1935, ekzistenca e të cilëve deri sot, të bën të kuptosh që objekti mban ende shtresën origjinale të suvasë.



*Fig. 14 – Elementët dekorativë në suvatimin e ballkoneve – elementë trgues që objekti mbart suvanë origjinale. Degradimi i suvasë*

Ky objekt nuk i është nënshtruar asnjëherë ndërhyrjeve restauruese ose rikonstruktuese gjenerale të tij. Me iniciativë individuale, shumë të pakta në numër janë bërë herë pas here, ndërhyrje me karakter riparues nga vetë banorët e kohës në objekt. Megjithatë, shpesh përdoruseit e tij e kanë dëmtuar sipërfaqen e mureve duke vendosur pa kriter elementë të ndryshëm të papërshtatshëm në muraturë (elementë metalikë për të mbajtur vazot e luleve, elementë metalikë për nderjen e rrobave, elementë metalikë për të kapur kabllot elektrikë ose

telefonikë). Nga sondazhet e kryera në objekt për të verifikuar qëndrueshmërinë dhe gjendjen e konservimit të shtrësës së suvasë, rezulton se është e dëmtuar deri në masën 70% të saj. (suva e rënë plotësisht, suva që ka humbur aftësinë e lidhësit duke formuar xhepa të shumtë, vendosje të elementëve të papërshtatshëm në muraturë, ndërhyrje të papërshtatshme riparuese të suvasë, etj.) Përveç pjesës së dëmtuar shtresa e suvasë ka edhe ndërhyrje të gabuara në të.



*Fig. 15 – Majtas - ndërhyrjet e papërshtatshme në objekt; djathtas – degradimi i suvasë dhe dekoreve përreth derës së ballkonit për shkak të lagështirës që ngjitet nga dyshemeja e ballkonit.*

Më e dëmtuar suvaja paraqitet në faqet e brendshme të ballkoneve në nivelet e poshtme, rreth 60-70 cm nga dyshemeja e ballkoneve. Mbjajtja e ujit në dyshemetë e ballkoneve, për shkak të mosfunksionimit të sistemit kullimit të ujërave ka bërë që uji të ngjitet për kapilaritet në sipërfaqen e mureve duke dëmtuar shtresën e suvasë si dhe *elementët e dekorit*.

Këta të fundit janë të realizuar me llaççimento, të derdhur më parë në kallëpë dhe më pas të montuar në vepër. Me kalimin e kohës, për shkak të kontaktit të vazhdueshëm me agjentët atmosferikë, për shkak të mungesës së kujdesit ndaj tyre nga përdoruesit si dhe përkundrazi nga dëmtimi mekanik i bërë nga vetë përdoruesit e objektit, kanë bërë që këta elementë të dëmtohen pjesërisht. Në disa raste parapetet e ballkoneve apo dritareve janë dëmtuar aq shumë sa që përdoruesit e kohës kanë bërë meremetime të herë pas herëshme. Gjatë këtyre riparimeve, asnjë element decori nuk është respektuar por parapetet ose janë plotëuar me llaççimento ose janë zëvendësuar plotësisht me parapete llaççimentotë derdhur në vend.

*Nëse sistemi i kullimit të ujërave është jo funksional, bëhet shkaku kryesor i degradimeve në një ndërtesë. Në objektin nr. 1, sistemi i disiplinimit të ujërave të shiut aktualisht është jashtë funksionit. Ky system i është besuar kryesisht elementëve të dekorit (atyre*

horizontalëperimetrale në tre nivele – dysHEMEJA e katit të parë; dysHEMEJA e katit të tretë; soleta e katit të tretë) si dhe tubave vertikale të futur në muraturë. Pozicionimi I tyre nuk është I identifikueshëm në këtë fazë të projektit; njëgjë e tillë do të bëhet e mundur vetëm me fillimin e punimeve kur të bëhet çmontimi i çatisë. Ajrimi I tymrave të podrumit realizohet nëpërmjet dy tubave vertikale të pozicionuar në të dyja anët e kafazit të shkallëve dhe më pas janë suvatuar me të njëjtën suva si pjesa tjetër e muraturës. Këta dy tuba janë të realizuar me elementë qeramike, seksion kuadratik dhe dimensione rreth 40X40 cm.



*Fig. 16 – Majtas – element i ndërtimit të tubave vertikale të ajrimit të tymrave të podrumit; djathtas – mënyra e vendosjes së tyre në objekt.*

### **3. Ndërrhyrjet restauruese - metodologjia e ndërhyrjeve**

Ndërrhyrjet restauruese në objekt do të nisnin me proceset e hapjes së tij dhe proceset e prishjes: çmontimin e çatisë, heqjen e grilave dhe kasave në dyer e dritare, heqjen e suvasë së vjetër, çlirimin e objektit nga shtesat volumore të bëra ndër vite apo nga elementët e huaj të vendosur mbi sipërfaqen e objektit.

Ky është momenti më i përshtatshëm për të bërë verifikimet e elementëve të painspektuar plotësisht në fazën e dokumentimit, evidentimit të degradimeve dhe të hartimit të projektit. Po në këtë fazë bëhet një inspektim tjetër i objektit për të dokumentuar elementë të fshehur në strukturë ose problematika të fshehura. Bëhet dokumentimi i objektit në këtë gjendje dhe nëse do të jetë e nevojshme, bëhen plotësimet e projektit të restaurimit por mund të ndodhë të lindë nevoja edhe për ndryshimin e tij pjesor.

Pas çmontimit të çatisë ekzistuese, pas evidentimit të të gjitha problematikave që objekti mbart, të shqyrtimit nëse disa nga elementët ekzistues mund të ripërdoren ose jo, do të bëhet ndërtimi i çatisë së re e cila do të bëhet duke respektuar teknikën dhe dimensionet e çatisë ekzistuese. Në ndryshim nga kjo e fundit, çatia e re do të ketë edhe shtresat hidroizoluese dhe termoizoluese.

Kati përdhe i objektit është kati i cili ka pësuar tjetërsimet më të mëdha gjatë viteve të shfrytëzimit. Deri para vitit 2000 në ky kat kishte një portik me kolona të lidhura ndërmjet tyre me harkadë; portik i shfrytëzueshëm nga kalimtarët. Pas këtij viti kjo hapësirë mori funksion tregëtar dhe hapësira midis kolonave u mbyll me vetratë d/alumini në tre kolonat e para dhe pjesërisht me mur dhe pjesërisht me vetratë d/alumini në dy kolonat e dyta. Pas këtij ndryshimi objekti humbi një ndër elementët estetikë më të rëndësishëm të tij; portikun.

Për t'ia rikthyer këtë element arkitektonik objektit, është zgjedhur të hiqen të gjitha vetratat e d/aluminit si dhe të hapen pjesët e mbyllura me muraturë duke evidentuar ritmin e kolonave dhe harqeve. Vetrata e re e d/aluminit është montuar në pjesën e brendëshme të muraturës (si paraqitur në hollësi). Sipërfaqja që duhet të mbyllet me xham është zgjidhur me dy fleta vertikale xhami të cilat bashkohen midis tyre me shirit silikon pa ngjyrë. Një hapësirë dritë nga kolona në kolonë është rreth 355 cm e gjerë dhe lartësia e tyre është rreth 420 cm. Por për të bërë porositetin e vetratave të reja duhet të maten në vend për çdo hapësirë. Gjithashtu do të hiqen të gjithë elementët e reklamave voluminoze që dalin jashtë sipërfaqes së murit. Reklamat e reja do të vendosen vetëm të printuara në ngjytës dhe të ngjiten në sipërfaqen e xhamave. Do të hiqen tendat e diellit me konstruksion metalik. Tendat e reja mund të vendosen vetëm në anën e brendëshme të dyqaneve dhe të jenë të kontrollueshme po nga brenda.

Për sa i përket ndërhyrjeve të tjera në fasadë në katet e tjera, u pa e arsyeshme që suvaja e vjetër të hiqej e gjitha pasi kishte humbur aftësinë e saj mbrojtëse. Është pjesërisht e rrëzuar dhe pjesa e mbetur në muraturë kishte krijuar xhepa në masën 60% të saj. Duhet theksuar se kjo është hera e parë që objekti rikostruktohet tërësisht. Objekti do të risuvatohet me suva llaç gëlqere 1:3 edhe pse në përbërjen e suvasë origjinale ka edhe një sasi çimento. Është zgjedhur të përdoret suvaja me llaç gëlqere sepse është lloji i suvasë më miqësore ndaj materialit të muraturës sepse fortësia që arrin suvaja është më e butë se ajo e vetë materialit duke bërë kështu që agresionet e agentëve atmosferikë ti përballojë suvaja.

Pas zhveshjes së objektit nga suvaja ekzistuese, I duhet dhënë kohë muraturës të thahet (në zonat ku ka mbajtur lagështirë) përpara se të risuvatohet.

Për sa I përket elementëve të degraduar të dekoreve, fillimisht do të bëhet kruajtja e tyre me spatul dhe furçë të butë teli deri sa të hiqet tërësisht materiali I degraduar dhe ajo pjesë që mbetet e dekoreve të jetë solide. Si hap I dytë do të jetë përgatitja e kallëpëve për çdo profil të veçantë dekori, nëpërmjet të cilëve më pas do të bëhet e mundur plotësimi në vend I

elementëve të degraduar. Për plotësimin e elementëve të dekoreve do të përdoret llaç gëlqere dhe çimento. Në rastin e dekoreve, përdorimi i çimentos është i përshtatshëm duke qenë se elementët e dekorit janë më të ekspozuar se suvaja në përgjithësi si ndaj dëmtimeve që vijnë për shkak natyrore (agjentët atmosferikë) si ndaj dëmtimeve mekanike. Raporti i çimentos, gëlqeres dhe rërës nuk duhet të jetë më i dobët se respektivisht 1:3:12 sepse ndryshe gëlqerja do të ulë rezistencën e llaçit ndaj ngricave. Megjithatë raporti nuk duhet të jetë as më i fortë se 1:2:9 sepse kjo është një përbërje e paërshtatshme për objektet e trashëgimisë.

Pas risuvatimit dhe përfundimit të elementëve të dekorit do të bëhet vendosja e të gjitha dyerve dhe dritareve në fasadë me po të njëjtin konfiguracion, dimension, ngjyrë dhe material si kanë qenë origjinalet. Dimensionet konkrete të porosities së dyerve dhe dritareve duhet të maten rigorozisht në vepër.

Më në fund, do të bëhet lyerja e objektit me bojë hidromat "kodi HC-58" referuar katalogut universal të ngjyrave. Është përcaktuar kjo ngjyrë pas sondazheve të kryera në objekt për të nxjerrë shtresën e parë të bojës (lyerjes) së aplikuar në objekt. Dekoret do të lyhen me bojë hidromat, ngjyrë të bardhë.

*Sondazhet për të evidentuar ngjyrën origjinale realizohen nëpërmjet goditjeve të lehta me spatul mbi sipërfaqen e muraturës duke bërë të mundur heqjen me kujdes të shtresave të ndryshme të bojës deri sa të arrijmë në sipërfaqen e llaçit të suvasë. Ngjyra e shtresës së fundit të bojës përcakton edhe ngjyrën më të cilën do të lyhet objekti pas ndërhyrjeve restauruese.*

Procurement  
Albania

## Objekti nr. 2

### 1. Përshkrim i objektit

Objekti nr. 2 është një ndërtesë 1 katëshe e mbuluar me çati me tjegulla vendi. Funkzioni i këtij objekti ka qenë gjithmonë për aktivitet tregtar. Është ndërtuar pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, rreth 15 vjet pas ndërtimit të sheshit "Avni Rustemi" dhe krijimit të Pazarit të Ri.

Objekti fillimisht ka qenë ndërtuar i mbuluar me tarracë e cila I mbivendosej në kufijtë e tij. Nuk ka pasur strehë por ka pasur një parapet rreth 80 cm të lartë

Pamja që ka sot objekti nuk është ajo fillestare por gjatë viteve të përdorimit të tij ka pësuar ndryshime; objektit i është hequr tarraca dhe i është bërë mbulimi me çati si dhe është zgjeruar sipërfaqja e katit përdhe. Dikur objekti ishte rreth 3m më i tërhequr në fasadën e tij kryesore (fasada perëndimore, ajo që sheh nga markata). Fasada e tij kryesore përsëriste elementin ritmik të kolonave të lidhura me harkadë, njësoj si objekti nr. 1. Megjithatë, edhe pse në një formë tjetër ky element është rujtuar edhe në fasadën e ndërtuar në kohën e zgjerimit të njollës së objektit.

Foto më poshtë është e bërë rreth viteve '50 – '60. Në këtë foto vihet re ekzistenca e harkadës si element dominues në objekt si dhe mbulimi I tij me tarracë dhe jo me çati siç është aktualisht.



*Fig. 17 – Foto e viteve '50-'60 – Pazari i Ri*

### 2. Gjendja e konservimit

Pas vlerësimit të imtësishëm të objektit në terren, mund të thuhet se objekti gëzon një gjendje të mirë konservimi. Si nga ana konstruktive, ashtu dhe muratura e rifinitura nuk shfaqin asnjë degradim që mund të vijë për shkaqe atmosferike, natyrore apo të jetëgjatësisë së objektit.

Megjithatë ndërtesa ka shumë ndërhyrje të papërshtatëshme, modifikime/shtesa volumesh të cilat ia kanë tjetërsuar pamjen.

Fasada kryesore mbart elementet kryesore, kolona dhe harqe, por harkada si një e plotë është e palexueshme për shkak të këtyre modifikimeve të realizuara ndër vite.

Fasada e mbrapme është tërësisht e pa suvatuar. Është muraturë tulle dhe është e lyer me gëlqere. Dy fasadat anësore të objektit janë të padukshme sepse objekti është i bashkënjgjitur me objekte të tjerë.



Fig. 18 – Foto aktuale e objektit nr. 2

- **Muratura** është ndërtuar me tulla qeramike të plota me dimensione 25x12x8cm, ngjyrë të kuqërremtë; lidhur me llaç çimento; suvatuar me llaç çimento dhe lyer me rul me bojë hidromat. Fasada nuk është e lyer e gjitha me të njëjtën ngjyrë pasi çdo zotërues i njësisë tregëtare ka ndërhyrë individualisht në to dhe përzgjedhje e ngjyrës ka qenë individuale gjithashtu. Nga vrojtimi i imtësishëm në objekt, vihet re që muratura në vetvete nuk paraqet të çara apo deformime, çka të bën të kuptosh që edhe sistemi konstruktiv është në gjendje të mirë. Për sa i përket ngjyrës origjinale të lyerjes së fasadës, është e pa mundur të realizohen sondzhe sepse, fasada perëndimore nuk mbart gjurmë të suvasë origjinale (fillestare, atë të viteve '67-'70) pasi ndër vite secili nga përdoruesit apo zotëruesit kanë bërë ndërhyrje, duke përfshirë ktu edhe risuvatimin.
- **Harqet e vetratave në fasadën perëndimore**, gjithashtu nuk janë të trajtuara njësoj; në përgjithësi janë të tjetërsuara, të përshtatura me funksionin që kanë marrë njësitë gjatë viteve të përdorimit të ndryshem (ndryshimit të tipologjisë së njësive tregëtare). Modeli më i vjetër i ruajtur i trajtimit të vetratave të harkadës, evidentohet në harkadën nr. 2 (nga veriu). Kjo vetratë është e punuar me dru pishë dhe trajtuar me vaj lini. Në pjesën fundore të harkadës, ka dy parapete, muraturë tulle 120x60cm. Mbi këta parapete është vendosur vetrata e palëvizëshme deri në lartësinë 220 cm nga toka. Dera e hyrjes brenda në njësinë tregëtare është e vendosur në qendër të harkadës, hapësira midis dy parapeteve dhe vetratave të palëvizëshme. Dera është tërësisht prej dru pishë, (nuk ka hapësirë xhami) dhe është e lartë 220cm. Mbi nivelin fundor të vetratës, njëkohësisht edhe derës



është pjesa e harkut e cila është tërësisht e mbyllur me dru pishe, të trajtuar me vaj lini. Tashmë ky element ruhet vetëm në dy harkada, në atë nr. 3 dhe në atë nr. 4. Materiali i drurit në këta dy harqe është i dëmtuar në pjesën e tij të sipërme, për shkak të lagështirës që vjen nga muratura si gjatë lyerjes së muraturës nuk është treguar kujdes për të mos e ndotur. Gjithashtu ky material manifeston edhe dëmtime pa kriter të bëra nga përdoruesit e njësive tregtare; dalja e tubave të ajrimit të aspiratorëve të njësive tregtare. Në harkadën nr. 1 pjesa e harkut është mbyllur me muraturë; në harkadën nr. 3, harku është i mbyllur përsëri me dru por është zëvendësuar kohët e fundit dhe druri është me ngjyrë natyrale, i palyer si të tjerët. Harqet e tjerë janë të mbyllur me vetratë dur-alumini.



*Fig. 19 – Mënyra e montimit të elementëve të drurit në pjesën e harqeve*

- Modeli i vetratës i ruajtur në harkun nr. 2 është dokumentuar gjatë fazës së hartimit të projektit dhe po gjatë kësaj faze është tjetërsuar në mënyrë individuale nga përdoruesi i njësive tregtare.



*Fig. 20 – Majtas, modeli më i vjetër i ruajtur i gjendur në harkun nr. 2 deri në mars 2015; djathtas, harku nr. 2 i tjetërsuar pas muajit mars 2015*

- Objekti është i mbuluar me **çati** vendi me tjegulla vendi; qeramike me ngjyrë kafe të errët dhe dimensione 19(12)x40.

Nga vrojtimi paraprak i bërë në brendësi të çatisë, (ky vërtetim është i mundur betëm në një pikë të një njësie tregtare) mund të thuhet se lënda drusore e konstrukcionit është në gjendje të mirë, por mungon shtresa e dyshemesë së drurit si dhe shtresa hidroizoluese.



*Fig. 21 – Konstrukcioni i çatisë*

Çatia ka një strehë të gjerë rreth 180 cm në fasadën perëndimore dhe rreth 50cm në atë lindore. Aktualisht kullimi i ujërave të shiut sigurohet nëpërmjet rënies së lirë të tyre nga strehët e çatave. Nuk ka sistem kullimi ujërash me ullukë shkarkimi, vertikale dhe as horizontale.

Në fasadën perëndimore, në anën e saj të majtë, është bërë një shtesë volumi në katin përdhe deri në lartësinë rreth 250-300 cm; një njësi tjetër tregtare. Pas ndërtimit të kësaj shtese, lindi si e domosdoshme vendosja e një tubi horizontal, në strehën e çatisë mbi këtë njësi, për disiplinimin e ujërave të shiut që rrjedhin nga streha mbi këtë shtesë volumore. Ky tub horizontal është vendosur nga vetë zotëruesi i njësisë tregtare (volumi shtesë).



*Fig. 22 – Volumi shtesë dhe segmenti i tubit të kullimit të ujërave*

Në fasadën perëndimore, gjendet edhe një segment tjetër tub shkarkimi horizontal. Ky është i vendosur përgjatë profilit tërthor fundor të strehës, në skajin ku objekti 2 bashkohet me objektin 1.

Streha e çatisë në fasadën perëndimore, në pjesën fundore të saj (bashkimi me objektin 1) ka lëndë drusore të kalbur për shkak të mos disiplinimit të ujërave të shiut në këtë zonë (prandaj është vendosur edhe tubi horizontal i kullimit të ujërave në këtë zonë).




Fig. 23– Pjesa e dëmtuar e strehës së çatisë

### 3. Ndërhyrjet restauruese

Gjatë fazës së zbatimit të projekt restaurimit, fillimisht do të nisët me *proçesin e çlirimit të objektit nga shtesat e kohës dhe ato të panevojshme* për qëndrueshmërinë apo për funksionimin e vetë ndërtesës. Do të prishen muraturat shtesë, (ballkonet të ndërtuar në gjysmën e lartësisë së katit në dy harqet fundore jugore, mbyllja e harqeve të dymëve në fasadë). Do të bëhet pastrimi i materialit të drurit që mbyll pjesën e harkadës së dymëve në fasadë. Në harqet ku ky element mungon do të bëhet I ri sipas odelit të ruajtur.

Do të hiqen krejtësisht vetratat e d/aluminit dhe do të zëvendësohen me dritare e dymë druri. Do të eliminohet tërësisht përdorimi i qepenave. Në rast se do të jetë i domosdoshëm vendosja e tyre do të gjendet një mënyrë që të mos jenë të dukshme vetë qepenat në fasadë, ndoshta të montohen në anën e brendshme të dyqaneve.

Do të bëhet heqja e tendave me konstruktion metalik - nëse është e domosdoshme, të vendosen tenda në pjesën e brendshme të njërive tregëtare dhe të jenë të unifikuara në design.

Do të bëhet zbulimi i *çatisë* nga tjegullat për të verifikuar gjendjen e saj të konservimit si dhe prezencën (ose jo) të shtersës hidroizoluese. Gjatë këtij procesi do të bëhet edhe përzgjedhja e tjegullave; tjegullat e rregullta do të ripërdoren për mbulimin e çatisë. Paraprakisht është

parashikuar që të bëhet zëvendësimi deri në masën 30% i elementëve drusorë të konstruksionit të çatisë. Kjo përqindje është përcaktuar *a priori* pasi inspektimi i gjendjes së koservimit të çatisë është e pa mundur në këtë fazë, por duke e vlerësuar gjendjen në përgjithësi të saj si dhe duke parë që nga çatia nuk ka infiltrim të ujërave të shiut në brendësi të objektit, është gjykuar që zëvendësimi i tyre në masën 30% është I mjaftueshëm. Gjatë restaurimit të çatisë do të shtohet shtresa e dyshemesë së drurit si dhe shtresa hidroizoluese.

Gjithashtu streha e çatisë (fasada perëndimore) në zonën ku objekti bashkohet me objektin nr. 1 është e dëmtuar për shkak të disiplinimit jo efikas të ujërave të shiut. Për zgjidhjen e këtij problemi do të vendoset fillimisht një impluv llamarine përgjatë të gjithë perimetrit të bashkimit të objektit nr.2 me objektin nr.1, do të bëhet heqja e materialit të degraduar të strehës dhe më pas zëvendësimi me material të ri, sipas modelit, dimensioneve dhe ngjyrës ekzistuese. Materiali i drurit të ri duhet të ketë të njëjtat karakteristika si ai aktual. (dimensionet do të verifikohen në objekt gjatë fazës së parë të zbatimit të projektit – faza e çlirimit të objektit nga ndërhyrjet e papërshtatëshme).

Fasada perëndimore aktuale e objektit nuk është ajo origjinale e vitit të ndërtimit të objektit. Fasada e re është ndërtuar duke përsëritur atë të vjetrën, pra në konfiguracionin e jashtëm ajo është po e njësoj.

Pas çlirimit të objektit nga të gjitha ndërhyrjet e papërshtatëshme, objekti do të suvatohet me llaç gëlqere (1:3) nga të dyja fasadat (lindore dhe perëndimore) dhe do të lyhet me bojë hidromat dhe ngjyrë të përcaktuar si në specifikime teknike. Kryerja e sondazheve për të evidentuar ngjyrën me të cilën objekti ka qenë I lyer është e pa mundur pasi faqja e jashtme perëndimore nuk është ajo origjinalja dhe përveç kësaj, objekti gjatë viteve të përdorimit objekti është risuvatuar nga zotëruesit. Për këtë arsye është gjykuar që edhe objekti nr. 2 të lyhet me të njëjtën ngjyrë si objekti nr. 1.

Në vend të vetratave të d/aluminit të përdorur aktualisht, do të vendosen vetrata druri. Moduli i përzgjedhur për të realizuar unifikimin e fasadës duhet të prodhohet me kasë dru pishe të stazhionuar minimalisht 5 vjet në mënyrë natyrale dhe të trajtuar me dy duar vaj lini, sipas modelit më të vjetër të ruajtur, atij në harkut nr. 2.

Zgjidhet ky konfiguracion i vetratës për të evidentuar më mirë ritmin e harkadës, e cila, rreth viteve 2000 u tjetërsua nga përdoruesit duke humbur kështu cilësinë e saj si i vetmi element me vlera estetike në këtë objekt.

### Objekti nr. 3

#### 1. Përshkrim arkitektonik

Objekti nr. 3 është një godinë dy katëshe e konceptuar për të qenë pjesë përbërëse e sheshit që në vitin 1926, vit kur arkitektët italianë G. Beçari dhe T. Giuliani kanë hartuar edhe projektin e përgjithshëm të sheshit së bashku me godinat përreth. Porositësi dhe zotëruesi e objektit nr. 3 ishte familja Kërçiku. Sot, pjesërisht ky objekt nuk përdoret më si vilë banimi por është shndërruar në hotel (krahu i djathë i vilës) dhe si bar dhe njësi tregëtare (krahu i majtë i vilës) Ndërtimi i vilës Kërçiku është bërë rreth vitit 1928-1930, në të njëjtën periudhë kur është bërë edhe zhvendosja e Pazarit në këtë zonë si dhe ndërtimi i vetë Sheshit “Avni Rustemi”.

Objekti nr. 3 është një ndërtesë dy-katëshe me mure mbajtëse ndërtuar me tulla të plota, ngjyrë të kuqe dhe dimensione 25x12x8cm, lidhur me llaç çimento. Objekti mbulohet me çati me tjegulla marsejeze, ngjyrë të kuqërremtë me dimensione 42x33x5cm. Përreth dritareve ka një kornizë të realizuar me llaç çimento dhe mbi dyert anësore ka strehë gjysmë rrethore të realizuar me beton.

Krahu i djathë i tij është rikonstruktuar dhe gjatë këtij procesi është ribërë tërësisht edhe suvaja e tij, pra ky krah nuk ruan gjurmë të suvasë origjinale dhe as të ngjyrës origjinale të lyerjes së fasadës. Për fat gjurmë të suvasë dhe ngjyrës origjinale të objektit ruan krahu i majtë, por vetëm në katin e parë të tij; kati përdhe i është nënshtruar rikonstruksionit dhe adaptimit duke bërë që t'i humbasë këto gjurmë. Kati përdhe është i veshur me pllaka mermeri në pjesët e kolonave, pjesa tjetër është vetratë xhami dhe vetëm një kolonë e këtij kati është e suvatur dhe e kyer me bojë hidromat; të bëra kohët e fundit. I gjithë objekti është i lyer (jo i gjithi njëkohësisht) me bojë hidromat me ngjyra të ndryshme; kjo i atribuohet faktit që objekti ka disa zotërues dhe përdorues, të cilët në kohë të ndryme kanë bërë ndërhyrje rikonstruese të pjesëshme për ta përshtatur objektin me funksionet e ndryshme.

Është vilë dy-familjare me zhvillim simetrik për sa i përket elementëve të fasadës kryesore, ndërsa për sa i përket zhvillimit planimetrik të tij vihen re shmangie nga simetria e plotë; projekti duhet ti jetë përshtatur kërkesave të porositësit si dhe orientimit të objektit kundrejt sheshit.

Në të dy krahët e ndërtesës ambjentet ballore të katit përdhe janë përdorur si njësi tregtare dhe kanë komunikim të drejtpërdrejtë me sheshin dhe njëkohësisht individual, duke rezervuar kështu zonën më të qetë të ndërtesës (pjesën e pasme) për zhvillimin e aktivitetit familjar. Hyrja për në pjesën e banimit bëhet në pjesën qendrore të ndërtesës, nëpërmjet një palë shkallëve të cilat të ngjisin në katin përdhe ku gjenden edhe dy dyert kryesore të krahëve të vilës.

Në të dy krahët e objektit në katin e parë janë të pozicionuar këta ambjente: tre dhoma gjumi, një kuzhinë gatimi dhe një banjë. Të treja dhomat e gjumit janë të orientuara nga sheshi “Avni Rustemi”.

Pavarësisht ndërrimit të destinacionit të përdorimeve që objekti ka pësuar ndër vite, ai vazhdon të ruajë të njëjtë volumetrinë e tij të përgjithshme. Megjithatë vihen re tjetërsime të elementëve dekorativë, sidomos në krahun e djathtë të objektit. (kornizat përreth dritares si dhe kangjellat e ballkonit).



fd

*Fig. 24 – Foto e viteve '60 e objektit nr. 3*

### 1. Gjendja e konservimit

Objekti nr. 3 nuk shfaq asnjë degradim për sa i përket sistemit konstruktiv apo muraturës. Vitet e fundit me sipërmarrje tërësisht private dhe individuale të zotëruesit të objektit, krahu i djathtë i është nënshtruar një procesi rikonstruksioni. Gjatë këtij procesi është treguar vëmendje dhe kujdes ndaj elementëve dekorativë të fasadës, duke u përpjekur të ruhen ose të rindërtohen, megjithëse jo rigorozisht sipas modelit origjinal. Krahu i majtë, ruan në formë më konservative këta elementë dekorativë.



*Fig. 25– Foto aktuale të objektit nr. 3*

Krahu i majtë i ndërtesës është zona e cila ka dëmtime në suva si dhe pjesërisht në elementë dekorativë, kryesisht që vijnë për shkak të lagështirës. Po kështu estetikisht objekti dëmtohet edhe nga prezenca e elementëve të ndryshëm të vendosur nga përdoruesit. (elementë metalikë për kapjen e kabllave elektrikë).

## 2. Ndërrhyrjet restauruese

Pas mobilizimit të sitit, do të bëhet heqja e elementëve metalikë apo kabllave elektrikë të kapur në fasadë në mënyrë të papërshtatshme. Më pas do të bëhet inspektim më i hollësishëm të zonave dhe sasia e suvasë së dëmtuar si dhe elementëve dekorativë të degraduar. Me spatul dhe furcë teli të butë do të bëhet heqja e suvasë së degraduar si dhe materialit të degraduar të dekoreve dhe më pas do të bëhet risuvatimi i këtyre zonave me suva me llaç gëlqere si dhe plotësimi i dekoreve me llaç gëlqere dhe çimento.

Elementët metalikë të krahut të majtë do të bëhet pastrimi nga ndryshku dhe më pas do të trajtohen me anti ndryshk dhe në fund do të bëhet lyerja e tyre. Në krahun e djathtë të objektit do të bëhet kthimi i elementëve të dekorit në formën e tyre origjinale (si i ka krahu i majtë) si dhe do të bëhet zëvendësimi i kangjellave të ballkonit; do të hiqen ato aktualet dhe do të bëhen të reja sipas modelit të ballkonit të krahut të majtë.

Gjithashtu në krahun e djathtë do të prishen kornizat ekzistuese, do të hiqen dritaret dhe do të zëvendësohen me dritaret sipas modelit të origjinalit.

Perpara çdo njesie tregtare do të vendosen tenda për mbrojtjen nga dielli sipas projektit. Në fundi do të bëhet lyerja e përgjithëshme e sipërfaqes së jashtme të muraturës si dhe elementëve dekorativë, ngjyra e të cilëve do të përcaktohet gjatë fazës së zbatimit të projektit pasi të realizohen sondazhet në pika të ndryshme në katin e parë të objektit; aktualisht ky kat është i paaksesueshëm.

## Objekti nr. 4

### 1. Përshkrim I shkurtër I gjendjes aktuale

Objekti nr. 4 është një kompleks godinash 1 katëshe të ndërtuara në vitin 1955 me destinacion zhvillim të aktiviteteve tregëtare, destinacion të cilin vazhdojnë ta ruajnë edhe aktualisht.

Objektet u ndërtuan perimetralisht oborrit të vilës që ndodhet në fillim të rrugës “Ludovik Shllaku”. Ndërtimi I kësaj vile ka nisur në vitin 1929 dhe ka përfunduar në vitin 1930, përpara se të ndërtohej edhe vetë sheshi “Avni Rustemi”.



*Fig. 26 – Foto gjatë ndërtimit të sheshit “Avni Rustemi”, viti 1931.*

*Vila në fillim të rrugës “Ludovik Shllaku”*

Pas viteve '90, në të gjithë objektet janë bërë ndryshime (ndryshim vteratash, shtesa volumore, instalim reklamash, vendosje tendash plastike) të cilat kanë sjellë si rezultat tjetërsimin e fizionomisë së kompleksit tregëtar, i cili edhe pse nuk mbarte asnjë element arkitektonik me vlerë, ishte i trajtuar i gjithi me një gjuhë duke bërë kështu që kompleksi të kishte uniformitet duke e u evidentuar kështu si një kompleks tregëtar. Sot kjo situatë është tërësisht kaotike dhe nuk është më e mundur të lexohet si kompleks tregëtar por si një mori njësisish tregëtare të vendosura rastësisht në atë vend dhe në atë mënyrë. E gjitha kjo vjen si rezultat i modifikimeve që i janë bërë objekteve në mënyrë individuale nga zotëruesit ose përdoruesit.

Përveç ndryshimeve të sipërpërmendura, një element tjetër vizualisht shqetësues është dhe sasia e madhe e oxhakëve, përmasat dhe lloji i ndryshëm i materilait të tyre si dhe prezenca e rezervuarëve të ujit mbi tarracat e dyqaneve.





*Fig. 27– Foto e vitit 1960”*



*Fig. 28– Foto aktuale e objekteve nr. 4*

## 2. Ndërhyrjet restauruese

Duke qenë se objektet nuk mbartin asnjë vlerë të veçantë arkitektonike, urbanistike apo historike, për të cilën duhet të përqipemi ta ruajmë, mund të themi se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me ndërhyrje restauruese por ndërhyrje rehabilituese të zonës. Si parim bazë këto ndërhyrje kanë unifikimin e fasadave dhe çlirimin e objekteve nga shtesat volumore të bëra ndër vite dhe tendeca për ta kthyer objektin sa më shumë të jetë e mundur në gjendje origjinale. Për këtë do të mbështetemi në materialet historike dhe fotografike të periudhës së ndërtimit të grup-objektit nr.4.

Për këtë do të hiqen të gjitha tendat të kapura me konstruksion metalik, reklamat e instaluar në parapetin e tarracës së tyre, do të bëhet ulja e lartësive të oxhakëve, aq sa të mos jenë më të dallueshme nga një kënd shikimi i këmbësorëve. Do të bëhet ngritja e lartësisë së parapetit me 20 cm. Do të hiqen të gjitha vetratat e d/aluminit dhe do të zëvendësohen me vetrata të reja. Do të bëhet heqja e qepenave mbyllëse të dyqaneve dhe tendave me konstruksion metalik. Do të bëhet zhveshja nga pllakat majolike të cilat veshin sipërfaqen e murit në disa pjesë të tij. Do të hiqet tërësisht suvaja ekzistuese.

Do të përdoren dritare të cilat do të hapen nëpërmjet një mekanizmi, do të shërbejnë dhe si tenda për të mbrojtur nga dielli.

Pas plotësimit të pjesëve të shembura të parapetit, do të bëhet suvatimi i plotë i të gjithë muraturës me llaç gëlqere dhe më pas lyerja e muraturës me bojë hidromat. Për sa i përket përcaktimit të ngjyrës së bojës, është menduar të lyhet me të njëjtën ngjyrë si objektet 1, 2 dhe 3, në mënyrë që të jenë më të unifikuara si fasada të një sheshi. Për sa i përket vendosjes së reklamave në dyqane, do të vepohet njësoj si në objektet e tjera; do të lejohen të vendosen vetëm reklama me adhesive, të ngjitura mbi sipërfaqen e xhamave. Ndërsa për tendat, nuk do të lejohen të vendosen tenda të cilat dalin si volume jashtë objektit, por do të mund të vendosen vetëm tenda të brendëshme, të instaluar në anën e brendëshme të dritareve; materiali i tyre mund të jetë i ndryshëm (beze ose metal) por është e domosdoshme që ngjyra të jetë e qetë (bezhë ose e bardhë).